

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

LIGJET DHE TATIMET NË
KOSOVË

P4

ZGJIDHJET

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme

Data 12.10.2024

Pjesa A. Detyra me zgjidhje të shumëfishtë (vetëm një opsion i saktë) Nga 2 pikë secila

1. Një faturë për blerjen e materialeve për 18,000 Euro përfshin TVSH prej 18%. Sa është vlera e TVSH-së?
 - a) **2,746 Euro**
 - b) 3,240 Euro
 - c) 1,800 Euro
 - d) 2,160 Euro

2. Kompania "Eko" pranon një faturë për 5,500 Euro nga furnitori i huaj për shërbime IT dhe përdor metodën e ngarkesës së kundërt për TVSH. Sa është vlera e TVSH-së së llogaritur?
 - a) **990 Euro**
 - b) 720 Euro
 - c) 880 Euro
 - d) 660 Euro

3. Kompania "SolarPrishtina" shiti panele diellore për 40,000 Euro (pa TVSH) dhe aplikoi një zbritje për energjinë e gjelbër prej 5%. Sa ishte shumta përfundimtare e shitjes me TVSH përfshirë zbritjen?
 - a) 38,000 Euro
 - b) 39,500 Euro
 - c) **44,840 Euro**
 - d) 38,500 Euro

4. Kompania "Digital Innovate" realizoi fitim prej 250,000 Euro për vitin 2023. Sa është shumta e tatimit mbi fitimin sipas normën bazuar ne TAK?
 - a) **25,000 Euro**
 - b) 22,500 Euro
 - c) 27,000 Euro
 - d) 30,000 Euro

5. Kompania "GreenEnergy" ka blerë një automjet elektrik për drejtorin e kompanisë për 30,000 Euro përfshirë TVSH. Sa është vlera e TVSH-së së zbritshme?
 - a) 4,500 Euro
 - b) **2,288 Euro**
 - c) 5,400 Euro
 - d) 3,000 Euro

6. Kompania "EKI Trade" realizoi një fitim para tatimit prej 400,000 Euro në vitin 2023. Sa është shuma e lejuar për sponsorizim në fushën e sportit?
- a) 20,000 Euro
 - b) 18,000 Euro
 - c) 24,000 Euro
 - d) 12,000 Euro**
7. Kompania "EcoClean" ka shpenzime për 8,000 Euro përfshirë TVSH me normen e reduktuar. Sa është shuma e TVSH-së së zbritshme?
- a) 1,200 Euro
 - b) 1,440 Euro
 - c) 593 Euro**
 - d) 960 Euro
8. Nëse një punonjës ka të ardhura bruto vjetore prej 12,000 Euro, sa është shuma e tatimit të pagës sipas Ligjit Nr. 08/L-142 me normat e reja tatimore ?
- a) 1,200 Euro
 - b) 792 Euro**
 - c) 900 Euro
 - d) 1,500 Euro
9. Nëse një kompani ka fitim para tatimit prej 500,000 Euro dhe aplikon një zbritje prej 20,000 Euro për donacione brenda normës së lejuar, sa është fitimi i tatueshëm?
- a) 480,000 Euro**
 - b) 460,000 Euro
 - c) 450,000 Euro
 - d) 470,000 Euro
10. Nëse një kompani ka një politikë zhvlerësimi prej 10% për pajisje me vlerë fillestare 50,000 Euro, sa do të jetë zhvlerësimi për vitin e parë?
- a) 4,000 Euro
 - b) 5,000 Euro**
 - c) 6,000 Euro
 - d) 7,000 Euro

Pjesa B. Pyetjet “E saktë/ E pasaktë”

Nga 1 pikë secila

1. Sipas Ligjit Per Shoqerit Tregtrae në Kosovë, një Shoqëri Tregtare mund të themelohet si biznes individual, ortakëri e përgjithshme, ortakëri e kufizuar, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose shoqëri aksionare.

Saktë

Pasaktë

2. Shoqëritë tregtare janë të detyruara të regjistrohen vetëm në qytetet ku zhvillojnë aktivitetet e tyre ekonomike.

Saktë

Pasaktë

3. Dega e një Shoqërie të Huaj Tregtare në Kosovë duhet të regjistrohet në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK).

Saktë

Pasaktë

4. Bazuar në Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Pasqyrat vjetore financiare të një shoqërie tregtare duhet të përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë, dhe pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet.

Saktë

Pasaktë

5. Të gjitha shoqëritë tregtare në Kosovë janë të obliguara të mbajnë librat kryesorë dhe të regjistrave kontabël për një periudhë të paktën 10 vjet.

Saktë

Pasaktë

6. Komiteti i auditimit i shoqërive me interes publik duhet të përbëhet nga drejtorë ekzekutivë me përvojë të konsiderueshme në fushën e kontabilitetit dhe financave.

Saktë

Pasaktë

7. Sipas Ligjit Për Administrimin e Procedurave Tatimore cdo person që i nënshtrohet ndonjë lloj tatimi të administruar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) duhet të regjistrohet në ATK dhe të pajiset me një numër fiskal para se të angazhohet në veprimtari ekonomike.

Saktë

Pasaktë

8. Bazuar në Ligjit Për Administrimin e Procedurave Tatimore Pasuria e një tatimpaguesi mund të konfiskohet nga ATK për të siguruar pagesën e një tatimi të papaguar.

Saktë

Pasaktë

9. Sipas Ligjit Për Administrimin e Procedurave Tatimore, personat që nuk kanë regjistruar biznes në ARBK nuk kanë nevojë të pajisen me numër fiskal.

Saktë

Pasaktë

10. Ligji Për Administrimin e Procedurave Tatimore , ATK-së i jep të drejtë të bëjë vizita pa njoftim paraprak për të mbledhur detyrimet tatimore dhe për të verifikuar përmbushjen e ligjeve tatimore.

Saktë

Pasaktë

11. Bazuar në Ligjin Për Administrimin e Procedurave Tatimore, tatimpaguesi mund të çregjistrohet nga ATK vetëm nëse ka deklaruar dhe paguar të gjitha detyrimet tatimore të tij.

Saktë

Pasaktë

12. Sipas Ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat Personale, pensionet e paguara në përputhje me legjislacionin përkatës mbi Pensionet në Kosovë nga Trusti Pensionsal, janë te ardhura te liruar nga tatimi sipas këtij ligji.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas Ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat Personale , të ardhurat nga interesat mbi depozitat bankare janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Saktë

Pasaktë

14. Sipas ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, vlerësimi i asetëve për qëllime tatimore kryhet çdo 5 vjet për të gjitha kompanitë.

Saktë

Pasaktë

15. Sipas ligjit të TVSh-se, Kompanitë e regjistruara për TVSH janë të detyruara të aplikojnë ngarkesën e kundërt për shërbime të pranuar nga furnitorë të huaj.

Saktë

Pasaktë

16. Sipas Ligjit të TVSH-së, TVSH aplikohet vetëm për transaksionet e brendshme dhe jo për importet.

Saktë

Pasaktë

17. Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, Çdo punëdhënës në Kosovë është i obliguar që të kontribuojë një përqindje prej 5% të pagës së punonjësve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Saktë

Pasaktë

18. Sipas Ligjit Për Fondet Pensionale të Kosovës, kontributet për skemat pensionale plotësuese individuale janë të detyrueshme për të gjithë të punësuarit në Kosovë.

Saktë

Pasaktë

19. Sipas Ligjit të Punës ne Kosovës, Punëdhënësi është i detyruar të lajmërojë të punësuarin në Administratën Tatimore të Kosovës dhe institucionet që menaxhojnë skemat e detyrueshme pensionale brenda një afati të caktuar pas fillimit të marrëdhënies së punës.

Saktë

Pasaktë

20. Sipas Ligjit të Punës ne Kosovës, Në rast të ndërrimit të punëdhënësit, kontrata e punës së punonjësit përfundon automatikisht dhe nuk bartet te punëdhënësi i ri.

Saktë

Pasaktë

Pjesa C. Pyetjet problemore

Problemi 1

8 pikë

Kompania **NINI Pharma LLC** ka realizuar një seri transaksionesh të ndërlikuara gjatë muajit Qershor 2024. Informacionet janë si më poshtë:

- Kompania ka blerë produkte farmaceutike me vlerë 50,000 Euro, përfshirë TVSH prej 8%.
- Gjithashtu, ka blerë produkte jo-farmaceutike me vlerë 30,000 Euro, përfshirë TVSH.
- Politika e shitjes së kompanisë për produktet farmaceutike aplikon një marzhë bruto prej 25%, ndërsa për produktet jo-farmaceutike aplikohet një marzhë bruto prej 30%.
- Përveç kësaj, kompania realizoi një blerje shtesë të pajisjeve laboratorike në shumën prej 20,000 Euro (pa TVSH), dhe aplikoi një politikë zhvlerësimi prej 10% për këto pajisje për qëllime tatimore.
- Shitja e produkteve jo-farmaceutike është kryer me një normë TVSH prej 18%, ndërsa produktet farmaceutike kanë një normë TVSH të reduktuar prej 8%.
- Kompania gjithashtu realizoi një shitje jashtë vendit në vlerë 15,000 Euro për produkte farmaceutike, ku TVSH-ja nuk është aplikuar, por zbritja e TVSH-së është e aplikueshme.
- Nuk kishte stoqe në fillim të muajit, ndërsa stoqet e mbetura në fund të muajit për produktet farmaceutike janë 10,000 Euro (pa TVSH).

Kërkohet: a) Sa ishte vlera e TVSH-së e zbritshme në këtë muaj?
b) Sa ishte vlera e TVSH-së e llogaritur në këtë muaj?
c) Sa ishte vlera e TVSH-së e pagueshme në këtë muaj?

Zgjidhje

a) Llogaritja e TVSH-së së zbritshme:

1. Blerja e produkteve farmaceutike:

- Vlera e blerjes: 50,000 Euro (përfshirë TVSH prej 8%)
- TVSH e përfshirë: $TVSH=50,000 \times 8 / 108 = 3,703.70$ Euro

2. Blerja e produkteve jo-farmaceutike:

- Vlera e blerjes: 30,000 Euro (përfshirë TVSH prej 18%)
- TVSH e përfshirë: $30,000 \times 18 / 118 = 4,576.27$ Euro

3. Blerja e pajisjeve laboratorike:

- Vlera e blerjes: 20,000 Euro + TVSH prej 18%
- TVSH : $20,000 \times 0.18 = 3,600$

Vlera totale e TVSH-së së zbritshme:

TVSH e zbritshme = $3,703.70$ Euro + $4,576.27$ Euro + $3,600$ Euro = $11,879.97$

b) Llogaritja e TVSH-së së llogaritur:

1. Shitja e produkteve farmaceutike (shitje vendore dhe jashtë vendit):

- Vlera totale e produkteve të shitura: 36,296.30 Euro
 - Marzhi bruto: 30%
 - Kostoja pa TVSH: $50,000 / 1.18 = 46,296.30.73$ Euro
 - Stoku 10,000
 - Shitja jashtë vendit: $15,000 \times 1.25 = 18,750$ Euro
 - Shitja vendore: $36,296.30 - 15,000 = 21,296.30 \times 1.25 = 26,620.38$ Euro
 - TVSH e llogaritur për shitjen vendore me normën 8%:
 $26,620.38 \times 0.08 = 2,129.63$ Euro

2. Shitja e produkteve jo-farmaceutike (me marzh prej 30%):

- Kostoja pa TVSH: $30,000 / 1.18 = 25,423.73$ Euro
- Marzhi bruto: 30%
- Shuma e shitjes: $25,423.73 \times 1.30 = 33,050.85$
- TVSH e llogaritur për shitjen e produkteve jo-farmaceutike (18%):
 $33,050.85 \times 0.18 = 5,949.15$ Euro

Vlera totale e TVSH-së së llogaritur:

TVSH e llogaritur = $2,129.63$ Euro + $5,949.15$ Euro = $8,078.78$ Euro

c) Llogaritja e TVSH-së së pagueshme:

TVSH e pagueshme=TVSH e llogaritur-TVSH e zbritshme

TVSH e pagueshme=8,078.78 Euro-11,879.97 Euro=-3,801.19 Euro

Përmbledhje përfundimtare:

- **TVSH e zbritshme:** 11,879.97 Euro
- **TVSH e llogaritur:** 8,078.78 Euro
- **Tepricë kreditore:** -3,801.19 Euro

Problemi 2

15 pikë

Kompania **UrbanBuild Sh.A.** filloi një projekt të ndërtimit të një kompleksi banesor që do të zgjasë për tre vite. Projekti përfshin ndërtimin e një blloku apartamentesh me sipërfaqe totale prej **12,000 m²** për shitje(. Të dhënat e mëposhtme janë dhënë për këtë projekt:

- **Të ardhura të planifikuara nga projekti:** 15,000,000 Euro (1,250 Euro për m²)
- **Kosto e parashikuar e projektit:** 10,000,000 Euro
- **Kosto e përditësuar e projektit në fund të vitit të tretë:** 11,500,000 Euro
- **Gjatësia e projektit:** 3 vite

Gjatë tre viteve të projektit, kompania ka regjistruar të ardhura:

Viti I: Kompania ka njohur të ardhura në bazë të keshit prej **3,500,000 Euro**,

Viti II: Kompania ka njohur të ardhura në bazë të keshit prej **4,000,000 Euro**,

Viti III: Ky vit shënon përfundimin e projektit dhe është bërë pranimi teknik i ndërtesës. Kompania ka njohur të ardhura të përziera: **800,000 Euro kesh** dhe **6,000,000 Euro në formë akruale** (nga marrëveshjet e shitjes, ku pagesat janë të arkëtueshme në periudhën e ardhshme).

Në fund të vitit të tretë, kostoja përfundimtare e projektit rezulton të jetë **11,500,000 Euro**, dhe kompania ka realizuar një total shitjeje prej **14,300,000 Euro** dhe në pritje për shitje **500,000 Euro**.

Të dhënat shtesë për vitin e tretë janë si më poshtë:

- **Llogari të arktueshme:** 6,000,000 Euro
- **Stoqe të mbetura të apartamenteve për shitje:** 500,000 Euro cmimi I shitjes.

Kërkohet:

- a) Sa është e ardhura e tatueshme dhe KMSH për vitin e parë dhe sa është detyrimi tatimor sipas TAK?
- b) Sa është e ardhura e tatueshme dhe KMSH për vitin e dytë dhe sa është detyrimi tatimor sipas TAK?
- c) Llogaritni diferencën e Kostos së Mallrave të Shitura (KMSH) që duhet rregulluar për dy vitet e para, duke marrë parasysh koston e përditësuar të projektit në fund të vitit të tretë.
- d) Sa është e ardhura e tatueshme dhe KMSH për vitin e tretë dhe sa është detyrimi tatimor sipas TAK?

Zgjidhje

Të dhënat e projektit:

- Të ardhura të planifikuara nga projekti: 15,000,000 Euro
- Kosto e parashikuar e projektit: 10,000,000 Euro
- Kosto e përditësuar e projektit në fund të vitit të tretë: 11,500,000 Euro
- Shitjet totale deri në fund të projektit: 14,300,000 Euro
- Stoque të mbetura në fund të vitit të tretë: 500,000 Euro (me çmim shitjeje)

a) Viti I - Të ardhurat e tatueshme dhe KMSH

Të ardhurat e tatueshme:

Në vitin e parë, kompania ka njohur të ardhura nga kesh prej 3,500,000 Euro.

Kostoja e Mallrave të Shitura (KMSH) - Viti I:

Koeficienti i KMSH=Kesh i pranuar në vitin I/Të ardhurat e planifikuara=3,500,000/15,000,000=0.2333

KMSH per vitin I=0.2333×10,000,000=2,333,333.33 Euro

Tatimi mbi fitimin:

Fitimi i tatueshëm për vitin I është:

Fitimi i tatueshëm=3,500,000-2,333,333.33=1,166,666.67 Euro

Tatimi mbi fitimin:

Tatimi mbi fitimin=1,166,666.67×10%=116,666.67 Euro

b) Viti II - Të ardhurat e tatueshme dhe KMSH

Të ardhurat e tatueshme:

Në vitin e dytë, kompania ka njohur të ardhura nga kesh prej 4,000,000 Euro.

Kostoja e Mallrave të Shitura (KMSH) - Viti II:

Koeficienti për llogaritjen e KMSH për vitin II është:

Koeficienti i KMSH=4,000,000/15,000,000=0.2667

KMSH për vitin II=0.2667×10,000,000=2,666,666.67 Euro

Tatimi mbi fitimin:

Fitimi i tatueshëm për vitin II është:

Fitimi i tatueshëm=4,000,000-2,666,666.67=1,333,333.33 Euro

Tatimi mbi fitimin= $1,333,333.33 \times 10\% = 133,333.33$ Euro

c) Diferenca e KMSH për dy vitet e para

Në fund të vitit të tretë, kostoja e përditësuar e projektit është 11,500,000 Euro. Kjo nënkupton se duhet të bëjmë rregullime për vitet e para dhe te dytë.

Rregullimi për vitin I:

KMSH e rregulluar për vitin I= $0.2333 \times 11,500,000 = 2,683,333.33$ Euro

Diferenca për vitin I= $2,683,333.33 - 2,333,333.33 = 350,000$ Euro

Rregullimi për vitin II:

KMSH e rregulluar për vitin II= $0.2667 \times 11,500,000 = 3,066,666.67$ Euro

Diferenca për vitin II= $3,066,666.67 - 2,666,666.67 = 400,000$ Euro

Diferenca totale për dy vitet e para:

Diferenca totale= $350,000 + 400,000 = 750,000$ Euro

d) Viti III - Të ardhurat e tatueshme dhe KMSH

Të ardhurat e tatueshme:

Në vitin e tretë, kompania ka njohur të ardhura nga kesh prej 800,000 Euro dhe 6,000,000 Euro në formë akruale.

Të ardhurat e tatueshme për vitin III= $800,000 + 6,000,000 = 6,800,000$ Euro

Kostoja e Mallrave të Shitura (KMSH) - Viti III:

- Stoku i mbetur është me çmim shitjeje prej 500,000 Euro.

Llogaritja e kostos së stoqeve të mbetura:

Kostoja për m²=Kostoja e përditësuar e projektit/Sipërfaqja totale= $11,500,000$ Euro/ $12,000$ m²= 958.33 Euro/ m²

Sipërfaqja e mbetur=Stoku me çmim shitjeje/Çmimi i shitjes për m²= $500,000$ Euro/ $1,250$ Euro/m²= 400 m²

Kostoja reale e stoqeve=Sipërfaqja e mbetur×Kostoja për m²= 400 m²× 958.33 Euro/m²= $383,333.33$ Euro

Llogaritja përfundimtare e KMSH për vitin e tretë:

KMSH për vitin III= $11,500,000$ Euro - ($2,683,333.33$ Euro + $3,066,666.67$ Euro) - $383,333.33$ Euro = $5,366,666.67$ Euro

Tatimi mbi fitimin për vitin e tretë:

Fitimi i tatueshëm për vitin e tretë do të jetë:

Fitimi i tatueshëm=6,800,000 Euro-5,366,666.67 Euro=1,433,333.33 Euro

Tatimi mbi fitimin:

Tatimi mbi fitimin=1,433,333.33×10%=143,333.33 Euro

Përmbledhje

Viti I:

- Të ardhurat e tatueshme: 3,500,000 Euro
- KMSH: 2,333,333.33 Euro
- Tatimi mbi fitimin: 116,666.67 Euro
- Viti II:
 - Të ardhurat e tatueshme: 4,000,000 Euro
 - KMSH: 2,666,666.67 Euro
 - Tatimi mbi fitimin: 133,333.33 Euro
- Viti III (me rregullimin për stokun):
 - Të ardhurat e tatueshme: 6,800,000 Euro
 - KMSH: 5,366,666.67 Euro
 - Tatimi mbi fitimin: 143,333.33 Euro
- Diferenca e KMSH për dy vitet e para: 750,000 Euro

Problemi 3

10 pikë

Kompania "GlobalMarketSolutions" LLC me seli në Prishtinë, ka prezantuar të dhënat financiare për aktivitetin afarist gjatë 12 mujorit të vitit të kaluar 2023. Kompania operon në importin dhe eksportin e mallrave tregtarë, me një gamë të gjerë transaksionesh që përfshijnë shitjet kesh, shitjet me afat, eksportet, dhe shpenzimet e ndryshme të operimit dhe investimit. Disa nga të dhënat janë si më poshtë:

- **Importe të rregullta mall tregtar:** 250,000 Euro (përfshirë TVSH 18%)
- **Avancet e pranua nga klientët:** 50,000 Euro (saldo me datë 31 dhjetor)
- **Eksport në Shqipëri:** 90,000 Euro (pa TVSH)
- **Shitjet kesh për klientë të rastit:** 400,000 Euro (përfshirë TVSH 18%)
- **Shitjet me afat për biznese:** 120,000 Euro (përfshirë TVSH 8%)
- **Shpenzimet administrative:** 20,000 Euro (pa TVSH)
- **Pagat Bruto:** 60,000 Euro (përfshirë kontributet pensionale të punëdhënësit)
- **Shpenzime të mirëmbajtjes:** 15,000 Euro (përfshirë TVSH 8%)
- **Blerjet vendore (materiale zyre):** 35,000 Euro (përfshirë TVSH 18%)
- **Provizioni për llogaritë e arkëtueshme:** 8,000 Euro
- **Import investiv (pajisje teknologjike):** 40,000 Euro (përfshirë TVSH 18%)
- **Shpenzimet e zhvlerësimit vjetor:** 25,000 Euro
- **Stoqet në fillim të vitit:** 100,000 Euro (me kosto)
- **Shpenzime për promovimin dhe marketingun:** 10,000 Euro (përfshirë TVSH 18%)
- **Stoqet në fund të vitit:** 120,000 Euro (me kosto)
- **Shpenzimet për konsulencë:** 50,000 Euro (përfshirë TVSH 18%)
- **Shpenzimet për transportin dhe logjistikën:** 12,000 Euro (pa TVSH)
- **Tërheqjet nga pronari:** 20,000 Euro (kesh)

Kërkesat:

- a) Llogaritni të ardhurat e tatueshme dhe Koston e Mallrave të Shitura (KMSH) për vitin 2023.
- b) Llogaritni tatimin në fitim për vitin 2023 duke aplikuar normën tatimore 10%.

Zgjidhje

1. Të ardhurat e tatueshme:

- Shitjet kesh për klientët e rastit: 400,000 Euro (përfshirë TVSH 18%)
 - Të ardhurat neto nga shitjet kesh: $400,000 / 1.18 = 338,983.05$ Euro
- Shitjet me afat për biznese: 120,000 Euro (përfshirë TVSH 8%)
 - Të ardhurat neto nga shitjet me afat: $120,000 / 1.08 = 111,111.11$ Euro
- Eksportet në Shqipëri: 90,000 Euro (pa TVSH)
 - Eksportet janë pa TVSH,

Të ardhurat e tatueshme totale për 2023:

TAT=338,983.05 Euro (shitjet kesh)+111,111.11 Euro (shitjet me afat)+90,000 Euro (eksportet)=540,094.16 Euro

Kostoja e Mallrave të Shitura (KMSH):

KMSH=Stoqet në fillim+Blerjet gjatë vitit–Stoqet në fund

- Stoqet në fillim: 100,000 Euro
- Blerjet gjatë vitit: 250,000 Euro (importe të rregullta, pa përfshirë TVSH-në)
 - Blerjet pa TVSH: $250,000 / 1.18 = 211,864.41$ Euro
- Stoqet në fund: 120,000 Euro

KMSH=100,000 Euro+211,864.41 Euro–120,000 Euro=191,864.41 Euro

b) Llogaritja e Tatimit në Fitim

1. Shpenzimet totale:

- Kostoja e Mallrave të Shitura (KMSH): 191,864.41 Euro
- Shpenzimet administrative: 20,000 Euro
- Pagat Bruto: 60,000 Euro
- Shpenzime të mirëmbajtjes: 15,000 Euro (përfshirë TVSH 8%)
 - Shpenzimet e mirëmbajtjes pa TVSH: $15,000 / 1.08 = 13,888.89$ Euro
- Blerje vendore (materiale zyre): 35,000 Euro (përfshirë TVSH 18%)
 - Shpenzimet për materialet e zyrës pa TVSH: $35,000 / 1.18 = 29,661.02$ Euro
- Provizioni për llogaritë e arkëtueshme: 8,000 Euro
- Shpenzimet e zhvlerësimit: 25,000 Euro
- Shpenzime për promovimin dhe marketingun: 10,000 Euro (përfshirë TVSH 18%)
 - Shpenzimet e marketingut pa TVSH: $10,000 / 1.18 = 8,474.58$ Euro
- Shpenzimet për konsulencë: 50,000 Euro (përfshirë TVSH 18%)
 - Shpenzimet për konsulencë pa TVSH: $50,000 / 1.18 = 42,372.88$ Euro
- Shpenzimet për transport dhe logjistikë: 12,000 Euro

:

SHPT=191,864.41 +20,000 +60,000 (+13,888.89 +29,661.02 +8,000 +25,000 +8,474.58+42,372.88 +12,000 =411,261.78 Euro

2. Të ardhurat neto te tatueshme te rregulluara:

Te ardhurat neto para rregullimit=540,094.16 Euro-411,261.78 Euro=128,832.38 Euro.

Fitimi i tatueshëm pas rregullimit=128,832.38 Euro+8,000 Euro=136,832.38 Euro

3. Tatimi në fitim (10%):

Tatimi në fitim=136,832.38 Euro×10%=13,683.24

Problemi 4

15 pikë

Kompania "InnovateTech SH.P.K.", me seli në Prishtinë, operon në sektorin e teknologjisë dhe inovacionit në gjithë Kosovën. Gjatë muajit Qershor 2024, kompania ka kryer disa transaksione komplekse që përfshijnë shitjet, blerjet dhe shpenzimet për një gamë të gjerë aktivitetesh. Të dhënat financiare për këtë periudhë janë si më poshtë:

1. **Shitjet brenda vendit me normë standarde** - Shuma e tatueshme: 30,000 Euro
2. **Shitjet brenda vendit me normë të reduktuar** - Shuma e tatueshme: 8,000 Euro
3. **Shitje të përjashtuara pa të drejtë kreditimi** - 5,000 Euro
4. **Shpenzime për shërbime ligjore të pranuar nga kompania jashtë vendit** - 2,000 Euro
5. **Import i pajisjeve harduerike** - 15,000 Euro
6. **Blerje pajisjesh softuerike për zyrë** - 50,000 Euro
7. **Import i një automjeti për qëllime operative** - 40,000 Euro
8. **Blerje nga subjekte jo të tatueshme** - 3,000 Euro
9. **Shpenzime për takime biznesi** - 1,200 Euro (normë standarde)
10. **Shpenzime administrative për aktivitetin ekonomik me normë standarde** - 1,000 Euro
11. **Shpenzime administrative për aktivitetin ekonomik me normë të reduktuar** - 600 Euro
12. **Notë kreditore e lëshuar me normë standarde** - 800 Euro (shuma e tatueshme)
13. **Notë kreditore e pranuar me normë standarde** - 900 Euro (shuma e tatueshme)
14. **Fatura e borxhit të keq e lëshuar me normën standarde** - 600 Euro (shuma e tatueshme)

Vlerat e paraqitura janë **pa përfshirë TVSH-në**. Koeficienti për vitin 2024 është **85%** dhe do të aplikohet për këtë muaj.

Kërkesa:

Përpiloni **ekstraktin e deklaratës së TVSH-së** për "InnovateTech SH.P.K." për muajin Qershor 2024, duke treguar se sa ka pagesë apo kreditim. Përfshini **llogaritjet e hollësishme të TVSH-së së llogaritur dhe të zbritshme**, duke aplikuar normat përkatëse dhe koeficientin e përmendur.

Zgjidhje

[TV] FORMULARI I DEKLARIMIT TË TVSH

Periudha e Deklarimit: s06/2024
 Numri fiskal: 800111222
 Emri i biznesit: InnovateTech
 Emri is personit kontaktues: SH.P.K
 Elon
 Pasha

		Furnizimet		
Shitjet e liruara pa te drejtë kreditimi	[9]	5,000		
Shitjet e liruara me drejtë kreditimi	[10]			
Eksportet	[11]			TVSH e llog
Shitjet e tatushme me normën 18%	[12]	30,000	[13]	5,400.00
Shitjet e tatushme me normën 8%	[14]	8,000	[15]	640.00
Nota debitore e leshuar,nota kreditore e pranuar me normë 18%	[16]	765.00	[17]	137.70
Nota debitore e leshuar,nota kreditore e pranuar me norme 8%	[18]		[19]	0
Fatura e borxhit te keq e pranuar, inkasimi I B.K me normë 18%	[20]		[21]	
Fatura e borxhit te keq e pranuar, inkasimi I B.K me normë 8%	[22]		[23]	
Rregulimet per te rritur TVSH-në me normë 18%	[24]		[25]	
Rregulimet per te rritur TVSH-në me normë 8%	[26]		[27]	
Blerjet qe I nënshtrohen ngarkesës së kundërt	[28]	2000	[29]	360.00
			[30]	6,537.70
				Totali I së llog
Blerjet dhe importet pa TVSH	[30]	34,044.9		
Blerjet dhe importet investive pa TVSH	[31]			
Blerjet dhe importet meTVSH jo te zbritshme	[33]	1,416.00		
Blerjet dhe importet investive meTVSH jo te zbritshme	[34]			*Tvsh e zbrit
Importet me normë 18%	[35]	34,000.00	[36]	6,120.00
Importet me normë 8%	[37]		[38]	-
Importet investive me normë 18%	[39]		[40]	-
Importet investive me normë 8%	[41]		[42]	
Blerjet vendore me normë 18%	[43]	850.00	[44]	153.00
Blerjet vendore me normë 8%	[45]	43,010.00	[46]	3,440.80
Blerjet investive vendore me normë 18%	[47]		[48]	
Blerjet investive vendore me normë 8%	[49]		[50]	
Blerjet nga feremrët vendore me normë 8%	[51]		[52]	
Nota debitore e pranuar,nota kreditore e lëshuar me normë 18%	[53]	800	[54]	144
Nota debitore e pranuar,nota kreditore e lëshuar me normë 8%	[55]		[56]	0
Fatura e borxhit te keq e lëshuar, pagesa e borxhit të keq me normë 18%	[57]	600	[58]	108
Fatura e borxhit te keq e lëshuar, pagesa e borxhit të keq me normë 8%	[59]		[60]	

Rregulimet per te ulur TVSH-në me normë 18%	[61]		[62]	
Rregulimet per te ulur TVSH-në me normë 8%	[63]		[64]	
E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt me normë 18%	[65]	1,700	[66]	306
			[67]	10,271.80
		Kalkulimi		Totali I TVSH së Zbr
Teprica e TVSH-së e bartur nga muaji I kaluar	[68]			
Balanca kreditore e mbetur $69=((67+68)-30)>0$	[69]			
Kërkesa për rimbursim	[70]			
Kreditimi I tvsh-së për muajin pasues $71=(69-70)$	[71]			
TVSH që duhet te paguhet $72=(30-67-68)>0$	[72]	(3,734.10)		

Problemi 5

6 pikë

Kompania "TechFuture Sh.p.k", e themeluar në vitin 2021, është një kompani e fokusuar në inovacion dhe zgjidhje teknologjike në Kosovë. Në fund të vitit 2023, kompania kishte regjistruar shpenzime të ndryshme për zhvlerësimin e aseteve të saj të shumta që përfshijnë disa kategori komplekse. Politikat kontabël të kompanisë janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, por ekzistojnë disa mospërputhje me rregullat tatimore të Kosovës, gjë që krijon një situatë enigmatike për departamentin e financave të kompanisë.

Të dhënat për asetet e kompanisë të blera me themelim të kompanisë janë si më poshtë:

- **Grupi I:**
 - **Selia Qendrore e Kërkimeve:** 7,500 Euro
 - **Laboratori i Inteligjencës Artificiale (AI):** 12,000 Euro
- **Grupi II:**
 - **Furgoni për Transport të Produkteve Eksperimentale:** 3,000 Euro
 - **Pajisje për Serverët Cloud:** 8,000 Euro
- **Grupi III:**
 - **Makina Përpunuese për Prototipet:** 8,000 Euro
 - **Robotët për Prodhimin Automatik:** 9,000 Euro

Informacion shtesë:

Politikat kontabël për zhvlerësimin e këtyre aseteve përdorin këto norma:

- **Grupi I:** 3.5%
- **Grupi II:** 14%
- **Grupi III:** 10.5%

Sipas **Ligjit Tatimor të Kosovës**, normat e zhvlerësimit janë si më poshtë:

- **Grupi I:** ?
- **Grupi II:** ?
- **Grupi III:** ?

Megjithatë, financat e kompanisë përfshijnë një komplikim shtesë. **Grupi II** përmban disa pajisje që kanë qenë në përdorim për 3 vite, dhe rregullat kontabel lejojnë një **ulje të veçantë** për pajisjet që kanë arritur fundin e jetës së tyre ekonomike, duke krijuar mundësi për një **deduktim të përshpejtuar të zhvlerësimit (Pajisje për Serverët Cloud ne vitin 2023 zhvleresohen ne teresi)**. Kjo rrit kompleksitetin e llogaritjeve të zhvlerësimit dhe bën që disa llogaritje të zhvlerësimit kontabël të jenë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me praktikën tatimore.

Kërkesa:

- a) Llogaritni zhvlerësimin tatimor për secilin aset, duke marrë parasysh normat e përcaktuara për çdo grup.
- b) Llogaritni diferencën mes shpenzimeve të zhvlerësimit kontabël dhe zhvlerësimit sipas ligjit tatimor.
- c) Llogaritni ndikimin e kësaj difference në të ardhurat e tatueshme dhe sasinë e tatimit të pagueshëm për vitin 2023.

Zgjidhje

Grupi	Asetet	Kosto	Norma e zhvleresimit kontabel (%)	Norma e zhvleresimit tatimor(%)	Zhvleresimi kontabel	Zhvleresimi tatimore	Diferencat
Grupi I	Selia Qendrore e Kerkimeve	7500	3.5	5	262.5	375	-112.5
Grupi I	Laboratori i Inteligjenc Artificiale	12000	3.5	5	420	600	-180
Grupi II	Furgoni per Transport te Produkteve Eksperimentale	3000	14	20	420	600	-180
Grupi II	Pajisje per Serveret Cloud	8000	14	20	5760	1600	4160
Grupi II	Makina Perpunuese per Prototipet	8000	10.5	10	840	800	40
Grupi II	Robotet per Prodhimin Automatik	9000	10.5	10	945	900	45
TOTAL	Rritjae bazes tatimore						3,772.50

- **Diferenca totale mes zhvlerësimit kontabël dhe atij tatimor: 3,772.5 Euro**
- **Ndikimi në tatimin e pagueshëm për vitin 2023 (me normën e tatimit të korporatave prej 10%): 377.25 Euro.**

Në këtë rast, kompania do të paguajë 377.25 Euro më shumë tatim për shkak të ndryshimeve në shpenzimet e zhvlerësimit midis kontabilitetit dhe rregulloreve tatimore.

Problemi 6

6 pikë

Kompania "Future Vision" ka në staf tre anëtarë: një Menaxher Marketingu, një Projektues Grafik dhe një Përkthyes. Paga bruto për secilin anëtar për muajin Gusht 2024 është si më poshtë:

- Menaxher Marketingu: Paga Bruto 1,800 Euro
- Projektues Grafik: Paga Bruto 600 Euro
- Përkthyes: Paga Bruto 400 Euro

Kërkesat :

Llogaritni për secilin të punësuar:

- a) Kontributin pensional (KP)
- b) Detyrimin e tatimit në paga, sipas normave të reja tatimore
- c) Paga neto pas zbritjes së tatimit dhe KP-së.

Zgjidhje

1. Kontributi Pensional (KP)

- Menaxher Marketingu:
 - Kontributi pensional = $1,800 * 5\% = 90 \text{ Euro} + 90 \text{ Euro} = 180 \text{ euro}$
- Projektues Grafik:
 - Kontributi pensional = $600 * 5\% = 30 \text{ Euro} + 30 \text{ Euro} = 60 \text{ euro}$
- Përkthyes:
 - Kontributi pensional = $400 * 5\% = 20 \text{ Euro} + 20 \text{ Euro} = 40 \text{ euro}$

TOTAL KP **280 EURO**

3. Llogaritja e Tatimit mbi Pagën

Tatimi mbi pagën përlllogaritet pas zbritjes së kontributit pensional prej 5% nga paga bruto. Tatimi llogaritet sipas këtyre normave:

- 0% deri në 250 euro
- 8%- për të ardhura nga 250 -450 euro
- 10% për të ardhura mbi 450 euro

Për secilin të punësuar, fillimisht zbresim kontributin pensional nga paga bruto për të marrë pagën e tatueshme dhe më pas zbatojmë normat tatimore.

- Menaxher Marketingu:
 - ✓ Paga bruto: 1,800 Euro
 - ✓ Paga e tatueshme pas zbritjes së kontributit pensional: $1,800 - 90 = 1,710 \text{ Euro}$
 - ✓ Llogaritja e tatimit:
 - Nga 0 - 250 Euro = 0 Euro tatim
 - Nga 250 - 450 Euro: $(450 - 250) * 8\% = 16 \text{ Euro}$
 - Mbi 450 Euro: $(1,710 - 450) * 10\% = 126 \text{ Euro}$
 - **Tatimi total = 16 + 126 = 142 Euro**
- Projektues Grafik:
 - ✓ Paga bruto: 600 Euro
 - ✓ Paga e tatueshme pas zbritjes së kontributit pensional: $600 - 30 = 570 \text{ Euro}$
 - ✓ Llogaritja e tatimit:
 - Nga 0 - 250 Euro = 0 Euro tatim
 - Nga 250 - 450 Euro: $(450 - 250) * 8\% = 16 \text{ Euro}$
 - Mbi 450 Euro: $(570 - 450) * 10\% = 12 \text{ Euro}$
 - **Tatimi total = 16 + 12 = 28 Euro**
- Përkthyes:
 - ✓ Paga bruto: 400 Euro
 - ✓ Paga e tatueshme pas zbritjes së kontributit pensional: $400 - 20 = 380 \text{ Euro}$
 - ✓ Llogaritja e tatimit:
 - Nga 0 - 250 Euro = 0 Euro tatim
 - Nga 250 - 380 Euro: $(380 - 250) * 8\% = 10.4 \text{ Euro}$
 - **Tatimi total 10.40 Euro**

TOTAL TAP 08/2024= 142+28+10.40 = 180.40

3. Paga Neto

Paga neto përlogaritet duke zbritur kontributin pensional dhe tatimin nga paga bruto.

- Menaxher Marketingu:
 - ✓ $\text{Paga Neto} = 1,800 - 90 \text{ (KP)} - 142 \text{ (TAP)} = 1,568 \text{ Euro}$
- Projektues Grafik:
 - ✓ $\text{Paga Neto} = 600 - 30 \text{ (KP)} - 28 \text{ (TAP)} = 542 \text{ Euro}$
- Përkthyes:
 - ✓ $\text{Paga Neto} = 400 - 20 \text{ (KP)} - 10.4 \text{ (TAP)} = 369.6 \text{ Euro}$